

V E N D I M
Nr.549, datë 7.11.1994

**PËR DIETAT E NËPUNËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT
TË TYRE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit e ndërmarrjeve dhe institucioneve që financohen nga buxheti, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës dhe nuk kthehen brenda ditës në familje, përfitojnë dietë në masën 10 për qind të pagës mujore, por pa kaluar 800 lekë në ditë dhe jo më pak se 400 lekë në ditë.

Shpenzimet e fjetjes paguhen sipas dokumenteve të paraqitura që e vërtetojnë atë, por pa kaluar 600 lekë për çdo natë të fjetur, kurse për ministrat dhe personat që barazohen me ta, sipas dokumenteve justifikuese. Shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas vleftës së biletës së udhëtimit me transport hekurudhor, automobilistik ose ujqor. Kur udhëtimi bëhet me taksj, shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas çmimeve të miratuara për linjën përkatëse me tren, autobus ose anije. Si shpenzime udhëtimit paguhen ato që efektivisht janë kryer dhe që dokumentohen në biletat e transportit urban.

2. Dërgimi me shërbim jashtë rrethit, ku banon nëpunësi dhe ka qendrën e punës, bëhet me autorizim të titullarit të institucionit ose zëvendësit të autorizuar prej tij. Në autorizim përcaktohet koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

3. Për efekt të llogaritjes së dietës, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten bashkërisht 1 ditë e plotë.

4. Personat që nuk janë në marrëdhënie pune dhe dërgohen ne shërbim, dieta u pagohet nga urdhëruesi i shërbimit në masën 600 lekë në ditë dhe shpenzimet e tjera sipas pikës 1 të këtij vendimi.

5. Punonjësit e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës së tyre, për rastet kur përfitojnë dietë dhe kthehen brenda ditës, jashtë kohës normale përfitojnë dietë në masën 250 lekë.

6. Nuk paguhet dietë kur shërbimi kryhet në qendrat dhe fshatrat që janë afër qyteteve ose qendrave të punës, në vende kur ka shërbim transporti të vazhdueshëm dhe që përcaktohen me vendim të këshillave të rretheve.

7. Studentët universitarë e parauniversitarë dhe nxënësit e kursantët e shkollave të ndryshme me ose pa bursë, kur dërgohen me shërbime të ndryshme, si për praktika mësimore, ekspozita e të tjera shërbime me karakter mësimor, u paguhet dietë në masën 400 lekë në ditë.

Nxënësve dhe studentëve me bursë dhe gjysmëburse, për kohën që marrin dietë, u pritët bursa për ushqim.

Trajtimi ushqimor i nxënësve dhe studentëve që gjatë kohës së praktikave mësimore nuk marrin dietë, por sistemohen në konvikte me mensë, të jetë në masën që ka konvikti përkatës ku kryhet shërbimi.

8. Sportistët, trajnerët dhe gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë që zhvillohen ndërmjet rretheve, përfitojnë dietë sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Kur veprimtaritë sportive kryhen brenda ditës, dieta do të jetë sipas pikës 5 të këtij vendimi.

Sportistët, trajnerët dhe gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë sportive që zhvillohen brenda rrethit, përfitojnë dietë në masën 200 lekë në ditë dhe shpenzimet e udhëtimit, për rastet kur u takon dietë. Për sportistët e zonave të largëta që nuk mund të kthehen brenda ditës, përfitojnë dietë në masën 300 lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit e të fjetjes.

Çiklistët për garat mbi 50 km, vozitësit dhe notarët mbi 5 km, peshëngritësit, maratonistët dhe alpinistët gjatë ditëve të veprimtarive sportive marrin, veç dietës, edhe një shtesë prej 100 lekësh në ditë.

9. Artistët e institucioneve kulturore dhe artistike, kur shkojnë me shërbim për të dhënë shfaqje jashtë rrethit, përfitojnë dietë në masën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Për veprimtaritë kulturore me sistem grumbullimi për konkurrim, olimpiadë, festival filmash e teatro profesionistë masa e dietës të jetë 800 lekë në ditë, për rastet kur u takon dietë sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Për grupet e filmit, kur shkojnë për xhirime jashtë rrethit, gëzojnë të drejtën e dietës 800 lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes sipas pikës 1.

10. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 23.12.1991 “Për të drejtat që u takojnë personave që dërgohen me shërbim”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.62, datë 11.2.1993 “Për disa ndryshime në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 23.12.1991 “Për të drejtat që u takojnë personave që dërgohen me shërbim”, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi